



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:138668

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06003907

KPPP.nr.408/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “IBAS” SH.A., me NUI:810195257, me seli në Prishtinë, rruga “Tirana” nr.91, kundër debitorëve 1. “Ranad” SH.P.K., me NUI:810147232, me seli në Prishtinë, rruga “Luan Haradinaj” 2. M.T., me vendbanim në Prishtinë, dhe 3. Rr.T., me vendbanim në Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbarim, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit “IBAS: SH.A. dhe debitorëve 1. “Ranad” SH.P.K., 2. M.T. dhe 3. Rr.T..
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin PPP.nr.337/23, të datës 27.12.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsytet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbare më është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare më, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbare më, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbare më (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbare më, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbare më. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbare më për përmbare më me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbare më sipas propozimit për përmbare më të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbare më të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbare më.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbare më është caktimi dhe zbatimi i përmbare më nga gjykata si organ përmbare më sipas propozimit për përmbare më të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbare më, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.408/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.